



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Prijmljena / Predato Received / Delivered	12-05-23	viti god. year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SKCL	4217/2023		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.523/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi ,anëtarë, me Vjollca Sinani - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës A.nr.523/2023 të datës 17.03.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “Kompensim Material”, në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 ,nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 12.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

**HEDHET POSHTË** si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.523/2023 e datës 17.03.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 17.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 523/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shtesës për zyrtar të Infrastrukturës Sportive-DS sipas Vendimit me shifër Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vlerën 250 € nga data 29.09.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 30.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli, me datë 12.04.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 3903/2023 të datës 28.04.2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën e ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 523/2023 të datës 17.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën e ankueses të datës 21.06.2018; Kërkesën e ankueses të datës 29.09.2020; Vendimin Nr.02/39 i datës 08.10.2008; Lista dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar për Infrastrukturë Sportive"; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.03.2023; Përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës e datës 12.04.2023; Përgjigjen më provat e lëndës të datës 12.04.2023; Akt emërimit e ankueses të datës 11.02.2013; Ankesë për koeficient e datës 03.02.2023; Lista e pagave, shkurt 2023; Lista e pagave, mars 2023; Vendimin me numër protokollit 3903/2023 të datës 28.04.2023 nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën e ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura në lëndë, të dërguara nga palët në procedurë, dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e jashtëafatshme, sepse:

Nga administrimi i provave materiale Kolegji ka gjetur se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 11.02.2013 është e punësuar në pozitën "Zyrtar i Sportit për Infrastrukturë Sportive" në Departamentin e Sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Më tej sipas shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja fillimisht më datë 21.06.2018 kishte parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm lidhur me njohjen e të drejtës së kompensimit të shtesës në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke pretenduar që ti bëhet pagesa në vlerë prej 250 euro, në mënyrë retroaktive nga data e fillimit të kontratës së ankueses, mirëpo ankueses nuk iu ishte realizuar kërkesa e saj, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se e njëjta nuk ka ndërmarrë asnjë hap procedural ankimor sikurse përcaktohej me dispozitat e ligjit material. Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja më datë 29.09.2020 ka përsëritur kërkesën e saj me numër protokollit 597/2020 tek Sekretari i Përgjithshëm lidhur me të njëjtin pretendim gjegjësisht për kompensimin e shtesës në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare.

Ndërsa organi i punësimit përkatësisht Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk i është kthyer përgjigjeje dhe rrjedhimisht e njëjta nuk e ka realizuar kompensimin e shtesës në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, sipas kërkesave të apostrofuara më lartë.

Ankuesja e pa kënaqur me mos përgjigjen dhe mos realizimin e kompensimit të shtesës në page sipas kërkesave të lartshënuara me datë 17.03.2023 parashtron ankesë me numër të protokollit 2758/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për kompensimin e shtesës në page për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, bazuar në Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të apostrofuuar edhe më lartë, në vlerë prej 250 euro, në mënyrë retroaktive nga data e fillimit të punës sipas kontratës së ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 përcakton se: *"1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 4. ,, Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, ndërsa në bazë të dëshmive të ofruara ka konstatuar se ankuesja Vlora Jahaj lidhur me mos përgjigjen në dy kërkesat e saj të datës 21.06.2018 dhe 29.09.2020 lidhur me kompensimin e shtesës në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut nga Sekretari i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ankesën në këshill e ka paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: 1. *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"* si dhe 4. *"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, pasi që e njëjta nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit konform afateve ligjore që nga viti 2018 gjegjësisht 2020 respektivisht nuk ka ndër marrë asnjë veprim procedural ankimor deri në ankesën e datës 17.03.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj ankesa si e tillë është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e LPPA-së.

Ndërsa kolegji i këshillit në lidhje me pretendimin sa i përket çështjes së realizimit të kësaj kërkesë në të ardhmen ju referuar faktit se organi i punësimit në përgjigje në ankesë të datës 12.04.2023 konstaton se kërkesa e ankueses është në fazën e shqyrtimit sa i përket kësaj çështje, andaj në lidhje me këtë pretendim kolegji nuk u lëshuar më tepër duke konstatuar se si kërkesë/ankesë është e parakohshme në këshill.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.523/2023, datë 12/05/2023.

Vjollca Sinani



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

